



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:049729

Datë: 29.01.2024

Numri i dokumentit: 05250782

P.nr.673/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Dibran Jusufi, me bashkëpunëtoren profesionale Sadete Kuqi Berisha, në çështjen penale kundër të akuzuarve N.B. dhe A.R., për shkak të veprës penale Vjedhja nga neni 313 par. 1 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP/II.nr.4420/20, të datës 11.03.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 24.01.2024, të hapur për publikun, në prezencë të prokurorit të shtetit Arianit Salihu, të akuzuarve N.B. dhe A.R., si dhe të dëmtuarit A.F., me datë 26.01.2024, morri dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 29.01.2024 me shkrim e përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

Të akuzuarit:

- 1). N.B. nga babai A., nëna N., e gjinisë A., i lindur me datë, në fshatin, Komuna e Prishtinës, me vendbanim në fshatin, rr.”...”, në, i pa martuar, ka të përfunduar shkollën e mesme, i punësuar në sektorin e ndërtimtarisë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal,
- 2). A.R. nga babai I., nëna M., e gjinisë R., i lindur me datë, në, me vendbanim në fshatin, Komuna e Lipjanit, i shkurorëzuar, baba i dy fëmijëve, ka të përfunduar shkollën e mesme, i pa punësuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal

JANË FAJTOR

Sepse me datë 03.09.2020, rreth orës 17:00, në rrugën “Theranda”, në Prishtinë, të pandehurit N.B. dhe A.R., me qëllim që me përvetësimin e pasurisë së huaj të luajtshme, vetit t’i sjellin përfitim pasuror të kundërligjshëm, kanë marrë rreth 15-20 metra gilindera (rrethoja të oborrit) nga shtëpia e të dëmtuarit A.F., i cili e kishte lëshuar për ndërtim të lartë, në atë mënyrë që rrethojat e tilla i kanë futur në veturën e të pandehurit N.B., të markës, ngjyrë e bardhë, me targa dhe janë larguar nga vendi i ngjarjes, të cilat më pas edhe i kanë shitur në vlerë prej 25 euro, me ç ‘rast të dëmtuarit i kanë shkaktuar dëm material,

-Me këtë, secili veç e veç, ka kryer veprën penale Vjedhja nga neni 313 par.1 të KPRK-së,

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4, 17, 38, 40, 42, 43, 47, 48, 49, 69 dhe 70 të KPRK-ës dhe neneve 242 e 364 të KPP-ës,

I GJYKON

I. Të akuzuarin N.B. me dënim me gjobë në shumë prej 300 € (treqind euro) i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

II. Të akuzuarin A.R. me dënim me gjobë në shumë prej 200 € (dyqind euro) i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale

III. Obligohen të akuzuarit secili veç e veç, që të paguajnë paushallin gjyqësor në shumën prej nga 20 € (njëzet euro), si dhe në emër të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej nga 20 € (njëzet euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të bëhet i plotfuqishëm, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

IV. Pala e dëmtuar A.F. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A R S Y E T I M

-Rrjedha e procedurës penale-

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me datë 16.03.2021, pranë kësaj gjykate, ka paraqitur aktakuzën me numër PP.II.nr.4420/20 të datës 11.03.2021, kundër të akuzuarve N.B. dhe A.R., për shkak të veprës penale Vjedhja nga neni 313 par. të KPRK-së.

Me datë 24.01.2024, pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ish-in prezent prokurori i shtetit Arianit Salihu, të akuzuarit N.B. dhe A.R. si dhe i dëmtuari A.F.. Në këtë seancë prokurori i shtetit ka lexuar aktakuzën lëndore, me ç ‘rast i akuzuari N.B. ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë, po ashtu edhe i akuzuari A.R. ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë ka shtuar se kërkon falje për rastin e ndodhur, me ç ‘rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 242 të KPRK-ës, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të akuzuarve.

-Vlerësimi i pranimit të fajësisë-

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë prezentë palët e lartcekura dhe pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të akuzuarve për veprën penale për të cilën akuzohen ngase kanë konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 242 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezentë. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se të akuzuarit e kanë kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarve, se të akuzuarit nuk ka qenë të detyruar ose të shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojnë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza, e po ashtu me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarve gjykata gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

-Gjendja faktike e vërtetuar-

Gjykata nga të lartcekurat ka vendosur që të akuzuarit secilin veç e veç ti shpall fajtor për veprën penale Vjedhja nga neni 313 par. 1 të KPRK-së, dhe i ka gjykuar si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që gjeti se të njëjtit janë penalisht përgjegjës dhe se nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale të të akuzuarve dhe se në veprimet e tyre manifestohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të kësaj vepre penale.

-Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqyrtimit të dënimit-

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të akuzuarve tu shqiptohet dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesve dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihen qëllimet e dënimit në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës, gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69, dhe 70 të KPRK-së, ashtu që rrethanë lehtësuese për të akuzuarin N.B. ka marrë faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë në një fazë të hershme të procedurës penale dhe kërkim faljen e të njëjtit, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata gjeti rrezikshmërinë shoqërore të kësaj vepre penale. Për të akuzuarin A.R., si rrethanë lehtësuese gjykata gjeti se i njëjti e ka pranuar fajësinë në një fazë të hershme të procedurës penale, se i njëjti ka shfaqur keqardhje për veprimet tij, ka kërkuar falje për veprimet e tij, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata gjeti rrezikshmërinë shoqërore të kësaj vepre penale. Gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarve mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të akuzuarve nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tyre, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

-Vendimi për kërkesën pasurore juridike-

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, pala e dëmtuar është udhëzuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil ngase në bazë të neni 462 par. 2, përcaktohet se “Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që tërë kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil”.

-Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale-

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par.2 pika 2.6 të KPPRK-së. Ndërsa, vendimi për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr komfor nenit 36 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.673/21, me datë 29.01.2024

Gjyqtari i vetëm gjykues

Dibran Jusufi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda tridhjetë (30) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.